



NEPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Vendi i marrëveshjes:	22. 10. 2020
Primi lloji:	Njësie
Jumlahica:	1-016 - 52639
Rezultati:	Shfcljeja e përfaqësuar
Rezultati:	E përfaqësuar

I lidhur me dt. 22/10/.2020, ndërmjet:

1. Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizate Joqeveritare me numër të regjistrimit 5113364-1 pranë Ministrisë se Administratës Publike, me adresë në rrugën Milosa Obilica në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv Isak Skenderi, në tekstin vijues VORAE;
2. Komuna e Lipjanit e përfaqësuar nga kryetari Imri Ahmeti, në tekstin vijues Komuna.

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje eshte ngritura e njohurive te zyrtareve komunal rreth antigipsizmit si formë specifike e racizmit dhe edukimi per pasojat me te cilat po perballen komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom si rezultat i veprimeve antigipsiste nga komuniteti shumice.

Kjo ndërhyrje ka të bëjë me edukimin kundër antigipsizmit e cila është pjesë e misionit për një kulturë univerzale për të drejtat e njeriut. Realiteti i përhapur i antigipsizmit në Kosovë e bënë të domosdoshëm adresimin e këtij fenomeni, jo sepse diskriminimi ndaj romëve është i ndryshëm nga diskriminimet e grupeve tjera por sepse realiteti ka dëshmuar se antigipsizmi direkt ose indirekt ka ndikuar edhe në arsimimin e komuniteteve ashkali, rom dhe egjiptian në Kosovë.


1. Kushtet e përgjithshme

VoRAE ka për qëllim që të adresojë antigipsizmin si fenomen i cili ndikon në situatën socio-ekonomike të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e sidomos te institucionet e nivelit local që ofrojnë shërbime të drejtperdrejta.

Ne jemi të vetëdijshëm që pjestaret e ketyre tre komuniteteve njohuritë bazike per realizimin e te drejtave te njeriut i kanë të mangëta, andaj po synojme që zyrtaret komunale pas trajnimit nga sherbimeve komunalesa ma cilesore karshi pjestareve te komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ne komunen e Ferizajit.

Prandaj VoRAE do të ofrojë ekspertizën e saj përmes sesioneve informuese që do të organizojë për zyrtarë komunal në komunën e Lipjanit si njëra ndër komunat me më së shumti numër të banorëve nga rradhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

3. Veprimet konkrete te Komunës



- Pas nënshkrimit të marrëveshjes Kryetari i Komunës do të përcaktojë Zyrtarin apo edhe drejtorinë Përgjegjëse me të cilin VORAE do të ketë bashkëpunim të ngushtë në realizim të sesioneve informuese me zyrtar komunal.
- Komuna duhet të njoftojë zyrtarët për bashkëpunimin me VoRAE dhe të ndajë MOU e bashkëpunimit me ta.
- Komuna do ti obligojë zyrtaret komunal për pjesëmarrje në sesione informuese.
- Komuna do të sigurojë hapsirat për mbajtjen e sesioneve informuese.

4. Veprimet konkrete te VORAE

- VoRAE do te ofroj ekspertizen profesionale sa i përket antigjipsizmit dhe do të ndajë njojuritë e saj me zyrtaret komunal.
- VoRAE obligohet që të ndajë materialet e antigjipsizmit me zyrtaret komunal dhe Komunën.
- VoRAE obligohet që të vlerësojë nivelin e njourive të zyrtareve komunal për antigjipsizmin përmes pyetësorëve që do të shpërndehen në fillim dhe në fund të sesioneve.

5. Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi dhe është e plotfuqishme që nga dita e nënshkrimit dhjetor 2021. Është valide deri ne përfundim të sesioneve informuese që pritet të organizohen deri në

6. Kushtet e Veçanta

Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.

Në rast se kjo marrëveshje nuk respektohet atëherë palët janë të obliguara të njoftojnë palen tjetër 30 ditë më herët për shkëputjen e marrëveshjes.

PALËT



Isak Skenderi